



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 244/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani Kryesues, Rafet Haxhaj dhe Xhevdet Abazi anëtarë, duke vendosur përkitazi për kërkesën e parashtruar nga Lëvizja Vetëvendosje (LVV), në seancën e panelit të mbajtur me 08.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Konstatohen të tërhequra ankesat me numër: Anr.164/2014, Anr.165/2014, Anr.166/2014, Anr.167/2014 dhe Anr.172/2014 të datës 05.06.2014, të parashtruara në PZAP, nga Lëvizja Vetëvendosje (LVV).

Arsyetim

PZAP, me datë 08.08.2014, ka pranuar një kërkesë për tërheqjen e ankesave me numër: Anr.164/2014, Anr.165/2014, Anr.166/2014, Anr.167/2014 dhe Anr.172/2014 të datës 05.06.2014, të parashtruara në PZAP kundër subjektit politik Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP), në të cilën kërkohet që të tërhiqen ankesat e lartpërmendura nga shqyrtim.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi kërkesën për tërheqjen e ankesave të sipërshënuara, me të cilën kërkohet nga PZAP-i që mos te shqyrtohen ankesat në fjalë, në kuptim të nenit 115.1 të LZP – së, PZAP – i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 244/2014 më datën 08.06.2014.

